



Informatë për shtyp - 316/04/2020

24.04.2020
faqe 1 nga 2

Proces i ri online për dëmshpërblimin në rast të dështimit të të hyrave për shkak të koronës

Zyra e Shtypit të Kancelarisë
Shtetërore
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
oder 0211 837-1151

Për t'u mbrojtur nga mashtruesit aplikimet duhet të bëhen vetëm përmes kësaj faqe interneti www.ifsg-online.de

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

Ministria për Punë, Shëndetësi dhe Çështje Sociale informon:

Dëmshpërblimet për dështimin e të hyrave për shkak të koronës mund të aplikohen online që nga e hëna, 27 prill 2020. Me aplikimin online punëdhënësit dhe bizneset mund të japin të dhënat dhe dërgojnë dëshmitë online: shpejt, thjeshtë dhe pa letra. Aplikimet dërgohen në zyrën përkatëse në mënyrë digjitale në Landin përkatës. Ky proces online është zhvilluar nga Ministria Federale e Brendshme, për Ndërtim dhe për Vendlindje si dhe nga Ministria për Shëndetësi e Landit Nordrhein-Westfalen. Përpos aplikimit online zyra përkatëse posedon me një software, e cila ndihmon për të përpunuar aplikimet në mënyrë eficiente. Kjo e redukton kohën e përpunimit të aplikimeve dhe shpejton dërgimet e mjeteve financiare.

Ministri Federal, Horst Seehofer: „Shteti duhet të jetë pranë qytetarëve – edhe atë shpejt, jo komplikueshëm dhe jo byrokratikisht. Kriza e koronës na tregon neve, se sa e rëndësishme është digitalizimi i administratës federale dhe të landit. Për këtë arsye ne po shpejtojmë dhe po digitalizojmë proceset që aktualisht kërkohen shumë dhe janë të nevojshme.“

Ministri i Shëndetësisë, Karl-Josef Laumann: „Mua më bënë shumë krenar, që me gjithë sfidat e krizës aktuale ne kemi arritur të zotërojmë këtë proces. Të parët nga dhjetë Lande Federale kemi arritur së bashku me Ministrinë Federale të Brendshme që të krijojmë në një kohë të shkurtë këtë proces të ri online. Tani më duhet vetëm të shfrytëzojmë aplikantët faqen tonë zyrtare të internetit. Me këtë mund të mënjanojmë, që datat e tyre përmes faqeve të rrejshme të bien në duartë e mashtruesëve, siç ka ndodhur herën e fundit tek ndihmat shtetërore.“

Informatat tjera:

Aplimiet mund të bëhen nga bizneset e vogla dhe punëdhënësit, të cilët ua japin një dëmshpërblim të punësuarëve të tyre. Të gjitha informacionet lidhur me të drejtën mbi dëmshpërblimin dhe procesin e aplikimit mund të gjinden që tash në faqen e internetit www.ifsg-online.de. Aplikimet mund të bëhen përmes të njëjtës faqe të internetit që nga java e ardhshme.

Kush është në karantenë ose për shkak të infeksionit nuk guxon të punojë dhe për këtë arsye ka pësuar një dështim të të hyrave mund të marrë një dëmshpërblim në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes nga Infektimi (IfSG). Që nga 30 marsi 2020 kjo vlen edhe për njerëzit, të cilët për shkak të mbylljes së kopshteve të fëmijëve ose mbylljes së shkollës nuk mund të shkojnë në punë. Një informatë e re është, që aplikimi për dëmshpërblim tani më mund të bëhet online.

Ky procesi online është zhvilluar dhe ofrohet në një bashkëpunim të ngushtë me nëntë lande tjera federale dhe nën prirjen e Ministrisë së Shëndetësisë të Landit Nordrhein-Westfalen dhe Ministrisë Federale të Brendshme, për Ndërtim dhe për Vendlindje. Më pas do të marrin pjesë në këtë proces edhe landet: Baden-Württemberg, Bremen, Hessen, Mecklenburg-Vorpommern, Niedersachsen, Rheinland-Pfalz, Saarland, Sachsen-Anhalt und Schleswig-Holstein.

Ky projekt është pjesë e digitalizimit të administratës, i cili po ecën përpara në kornizën e Ligjit për Çasje në Internet dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet landeve dhe federatës.

Udhëzim i rëndësishëm për qytetarë:

Ju duhet ta kontrolloni URL-në e aplikimit online dhe kujdesuni nga faqet mashtruese në internet përkatësisht web. Këshilla të tjera, se si ju mund të mbroheni në internet mund të gjeni në faqen e internetit të Entit Federal për Siguri Internacionale (BSI [Informationsseite](#)).

Në rast se keni pyetje drejtohuni tek zyra për shtyp e Ministrisë për Punë, për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, telefoni 0211 855-3118.

Ky tekst i shtypit mund të gjendet përmes faqes së internetit të Qeverisë së Landit www.land.nrw

[Udhëzime për mbrojtjen e datave lidhur me mediat sociale](#)